



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_2026

#### **Kriteret dhe specifikimet teknike të ambientit, për të cilat do të merren oferta nga personat e tretë, fizikë/juridike private**

##### **I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit:**

- Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës, të vërtetuar me certifikatë pronësie të lëshuar nga ASHK, së bashku me kartelën, hartën shoqëruese të pronës dhe genplanin;
- Vetëdeklarim që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore apo detyrim tjetër ligjor;
- Vetëdeklarim nga FSHU që nuk ka detyrime të pashlyera, si dhe kopje e kontratës së furnizimit me energji elektrike;
- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo në proces gjyqësor;
- Kopje e dokumentit të identifikimit të titullarit të pronës/ambienteve;
- Vërtetim i numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;
- Ofertë me shkrim për çmimin mujor të qirasë së ambienteve;
- Vetëdeklarim për përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe kriterëve ligjore-teknike të kërkuara nga Zyra e Komisionerit (qiramarrësi).

Nëse ofertuesi është tregtar/shoqëri tregtare, duhet të paraqesë gjithashtu:

- Vërtetim nga organet tatimore që nuk ka detyrime të pashlyera;
- Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera për sigurimet shoqërore (nga e-Sigurime);
- Ekstrakt nga QKR që vërteton statusin aktiv të subjektit.

##### **II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrjeje:**

- Sipërfaqja totale e ambienteve të brendshme të jetë 28–33 m<sup>2</sup>;
- Ambienti të ofrohet nga një subjekt zotërues i pronës;

- Ambienti duhet të jetë sa më pranë godinës ekzistuese dhe jo më shumë se 100 metra në vijë ajrore larg godinës së “Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në adresën Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, Tiranë;
- Objekti/ambienti duhet të ketë të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamera brenda dhe jashtë;
- Ambienti i brendshëm të jetë “Open Space”, i përshtatshëm dhe të ofrojë funksionalitet/ndarje për të sistemuar postet e punës së punonjësve të Zyrës së Komisionerit;
- Objekti duhet të ketë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe të jetë i pajisur me matësit përkatës;
- Objekti duhet të jetë i përfunduar me dyer, dritare, i lyster dhe i gatshëm/i lirë për t’u shfrytëzuar nga qiramarrësi;
- Objekti/ambienti duhet të ketë sistem kondicionimi dhe ajrimi, të instaluar dhe plotësisht funksional;
- Ambienti duhet të jetë bosh dhe i lirë; dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 ditëve nga njoftimi për lidhjen e kontratës;
- Ambienti/objekti në total duhet të ketë minimalisht 2 tualete të kompletuara me pajisje hidrosanitare dhe pajisje për ujë të ngrohtë;
- Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (ofertën ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi;
- Përzgjedhja e ofertës ekonomike do të bëhet duke vlerësuar çmimin më të favorshëm, si dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuara më sipër;
- Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit, me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.

### **III. Paraqitja e dokumenteve dhe ofertës së qirasë së ambienteve**

Dorëzimi i dokumenteve dhe ofertave ekonomike duhet të bëhet deri më datë 28 prill 2026, ora 16:00, me postë ose dorazi pranë institucionit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në adresën “Rruga ‘Abdi Toptani’”, Nd. 5, Tiranë.

Për çdo komunikim apo sqarim, lutemi na shkruani në adresën elektronike: [info@idp.al](mailto:info@idp.al).